



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 11.03.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arta Dade – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit shtesë 3 të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore”..
3. Të tjera.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Aldo Bumçi, Namik Dokle, Gramoz Ruci, Valentina Leskaj, Kastriot Islami, Eduard Selami, Vangjel Dule, Fatmir Mediu.

Mungojnë:

Ben Blushi, Olta Xhaçka, Përparim Spahiu, Jozefina Topalli, Gerti Bogdani, Shpëtim Idrizi,.

Të ftuar:

- Z. Armand Shandro, Drejtoria e Traktateve dhe së Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Jashtme;
- Z. Bashkim Sykja, Drejtor i Drejtorisë së Mbështetjes së Sipërmarrjes, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
- Z. Altin Bozgo, Përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- Z. Athanas Andoni, Përgjegjës i Sektorit të Origjinës Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

HAPET MBLEDHJA

Arta Dade – Të nderuar kolegë, nisim mbledhjen e rregullt të Komisionit me rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit shtesë 3 të marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore”..
3. Të tjera.

Të pranishëm për të mbrojtur projektligjin kemi zotërinjtë Z. Armand Shandro, Drejtoria e Traktateve dhe së Drejtës Ndërkombëtare, Ministria e Jashtme; Z. Bashkim Sykja, Drejtor i Drejtorisë së Mbështetjes së Sipërmarrjes, Ministria e Zhvillimit Ekonomik; Z. Altin Bozgo, Përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Z. Athanas Andoni, Përgjegjës i Sektorit të Origjinës Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Kush e do fjalën për të bërë prezantimin e projektligjit?

Altin Bozgo - Ne jemi zbatues më shumë se hartues, megjithatë mund të them që protokollin shtesë është në kuadër të marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Lindore Bosnja si vend nuk e nënshkroi këtë protokoll për arsye politike të brendshme. Me këtë protokoll shtesë parashikohet që tarifat për mallrat bujqësore në import të reduktohen, të zerohen. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i ka të gjitha kapacitetet të marrë masat që këto tarifa të implementohen në sistem dhe të zbatohen sapo të hyjë në fuqi ligji në fjalë.

Arta Dade – Zoti Shandro?

Armand Shandro – Për sa i përket shtesës së tretë të marrëveshjes për amendimet duhet thënë që Ministria e Punëve të Jashtme ka luajtur një rol në pjesën e problematikës politike që ka pasur brenda, deri tani Kosova ka qenë e përfaqësuar nga UNMIK, por së fundmi ne kemi rënë dakord që Kosova të jetë pjesë e kësaj marrëveshjeje duke u prezantuar si ... me asteriks, dhe duke e sqaruar që është subjekt sipas rezolutës 1244. Dhe së fundmi Republika e Shqipërisë renditet dhe depozituese e marrëveshjes CEFTA, dhe pikërisht këto problematika që dolën gjatë emrit të Kosovës ne kemi marrë këtu një “acting depositary”.

Fatmir Mediu – Është thjesht një zgjerim i marrëveshjes së tregtisë së lirë me Bosnjën dhe Kosovën dhe kaq? Apo jo?

Armand Shandro – Kjo marrëveshje është nënshkruar me të gjithë vendet që janë pjesëtarë të CEFTA-s, por që për problemet e tyre politike të brendshme nuk e kishin nënshkruar

akoma, dhe kjo është një vijimësi e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërmjet vendeve që janë anëtare të CEFTA-s.

Arta Dade – Bosnjë Hercegovina dhe vendet e tjera që janë pjesë e kësaj nisme ekatë realizuar një marrëveshje të tillë me të gjitha vendet?

Armand Shandro – Po, me të gjitha vendet.

Arta Dade – Po Kosovën përse e përmendët?

Armand Shandro – Sepse deri tani Kosova nuk prezantohej si subjekt i CEFTA-s por përfaqësohej nga UNMIK. Së fundmi u arrit që Kosova të nënshkruante si Kosovë por me shënim me asteriks duke shpjeguar si përfaqësohet ajo me rezolutën 1244.

Arta Dade – Është marrëveshje që do të realizohet dhe me vendet e tjera?

Armand Shandro – Po, patjetër. Me të gjitha vendet që janë pjesë e CEFTA-s.

Arta Dade – Mirë. Në qoftë se nuk kemi ndonjë gjë tjetër në lidhje me projektligjin e hedhim në votë. Kush është dakord që projektligji të propozohet për ratifikim në seancë plenare? Kundër? Abstenim? Miratohet.